

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-1

P 24

FERIDE PAPLEKA



Bashkudhëtarë


8SH-1

P 94

Feride Pappleka

BASHKUDHËTARË

poezi



1405

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

K R I J I M I

Çelin tek poetët motive
si sythe në pranverë;
në lule kthehet sythi,
motivi në vjershë.

Lules i bien petallet,
kuqëlon fruti te dega;
shkunden figura dhe fjalë,
piqet mendimi te vjersha...

PËR DIELLIN TONË PPSH

Vitet do t'ia lënë vendin njëri-tjetrit,
e rrepta kohë me gjuhën e saj
do të flasë,
ka dekada që na ngroh
me rreze të prushta
Dielli shqiptar.

Ky Diell na ndez gjakun në rremba,
sytë tanë të kthjellët i mbush
me dritë agimi:
rrezet e tij na projektojnë
madhështinë e fitoreve,
komunizmin...

Stinët e reja dhe brezat që do të vijnë
me hapa të mëdhenj do të ecin
mbi këtë tokë:
në të korrat, lulet, këngët, krenarinë
do të jetë shkëlqimi i madh
i Diellit tonë!

VAJZA E DRITËS

Në sallën ngjyrëvjollcë të komandimit
çelësi lëvizi me një zhurmë të lehtë,
dora e bukur e teknikes së shfrytëzimit
aparatit të heshtur i dha jetë.

Në nënstacion u ngarkuan telat
me elektronet e valës shkumëbardhë,
sahati vigan rrrotulloi akrepat
duke matur kilovoltët e parë...

Teknikes së re, të lindur në bjeshkë,
ëndërrues iu bënë sytë e kaltër,
iu kujtua mes shkrepash kulla e rreptë,
iu kujtuan nenet e kanunit të ashpër.

Ajo do të shitej sipas kanunit të zi,
me duvałk do të kalonte kësaj gryke,
me drutë mbi shpinë nëpër borë e shi
do të ecte e kërrusur në këto brigje.

Por koha e madhe, koha e Partisë,
i shkelmoi përgjithmonë këto nene...
Ajo buzëqeshë embël para aparatit preçiz,
turbina e parë sillet pandërprerje.

NË STAN

Ngjitet grigja në rudinat e gjelbra,
flladi i bjeshkës na futet në zemra.

Në muzg çobanët rreth zjarrit mblidhen,
tingujt e lahitës nën hark dridhen.

Hedh hëna sytë mes pishash vigane,
drita si qumësh rrjedh përmbi stane.

Valët lijeni rrathë-rrathë shpërndan,
uji i kaltëremë krahë bredhash lan.

Troket mesnata me trok përrallor:
gjethet fëshfërisin, bie një këmborë.

I mbyll sytë çobani dhe i çel prapë,
pushka pranë tij nuk fle asnje çast...

M È N G J E S

Rrezet e mëngjesit si qumësht i bardhë
fytyrës sate ia spërkatën gjumin,
i çel gonxhet e syve,
buzëqesh
dhe nxjerr gugatje pëllumbi.

Dhomës së qetë
ia merr qetësinë
me zërin e butë si flladi i bjeshkës,
i çel gonxhet e syve,
buzëqesh
dhe gishtin e ngre drejt derës.

Eja, bir,
të nisemi,
rrugë të mëdha na presin!...
Në fytyrën tënde
të njomësht
sikur ke të mbledhur tërë mëngjesin.

FUSHË E ARTË

Hëna si drapër i mprehtë
zbriti ngadalë mbi kodër,
shkau e ra nëpër duar
kalliri i rëndë ul kokën.

Fëmijët mbledhin kallëza,
vrapojnë me kite ndër duar;
vajzat e vogla si lulka,
sa shumë, sa shumë janë gjuar!

Gumëzhin në fushë kombajna,
duajt përtyp pa mbarim;
shushurin kjo fushë e artë,
nga gjiri na fal pjellorinë.

M A J

Bie mbrëmja e bruztë, e bruztë,
kundërmojnë trëndafilat në park,
fëmijët gumëzhijnë nëpër rrugë,
shëtisin të rintjtë në bulevard.

Lëvizin pandërprerje urbanët
duke çuar punëtorë nëpër turne,
nga flamurët, parullat, pllakatet
qyteti ka marrë ngjyrë të kuqe.

Në sytë e lumtur të njerëzve,
që mposhtin bllokadat me punë,
hedh yje të kaltër, reflekse
kjo mbrëmje e bruztë, e bruztë!

PLEQVE TË KRUJËS

Kur këndoni ju, o të rrëptë,
kalaja ushton,
ngrihet i pavdekuri Gjergj
me mall ju takon.

Përmbi flokët tuaj me thinja
zbardhon borë e kohës,
rrudhat në fytyrën fisnike
si brazdat e tokës.

Vitet le të rrjedhin varg,
o gjyshër dhe etër,
kënga juaj zgjatet lart
si bisk i gjelbër!

KOHË TJETËR

Buçet zhurma e minave,
koha shkund pluhurat e lashtë;
malësori që jetonte majë bjeshkëve
është bërë minator në hidrocentral.

I pëlqen kjo jetë plot zhurmë,
nga duart e tij do të burojë dritë;
te kulla në fshatin malor
qeshin të lumtur fëmijët...

B A S H K U D H È T A R È

Në kryqëzimet e viteve ne u takuam,
ja, dy udhëtarë jemi përsëri,
vitet trokasin në orën tonë të madhe,
vitet që pikojnë djersë e kaltërsi...

Ruga jonë i ngjan një të përpjete mali,
një fluturimi pambarim drejt diellit:
ne s'kemi krahë dylli si Dedali i lashtë,
që ra nga lart në greminën e detit.

Përherë do të udhëtojmë bashkë, i dashur,
pjesëtarë të ndershëm të dy milionëve,
në sy dritën dhe gëzimin më të pastër,
në zemër dashurinë më të madhe të kohrave!

NJË TUFË LULE

*Shoku Enver vendos një tufë lule
në monumentin e Luftës së Mash-
kullorës.*

Një tufë lule,
një besë trimi:
malet ushtojnë
si nga gjëmimi.

Një tufë lule,
një këngë e re;
notat epike
ngrihen në re.

Një tufë lule
nga dora e Tij,
një epigraf
mbi histori.

SI BURIM MALI...

«10 këshilltarë u pushkatuan!...»
Bregu ia dha bregut këtë lajm
dhe grykat e Gorishovës ushtuan,
sokëlliti Rrapo Hekali që larg.

Trupat tuaj si lisa të prerë
ranë mbi tokë atë natë me shi
dhe u bëtë ju një këngë e re,
një këngë që gjëmon si stuhi...

E heshtur rri para kësaj ndërtese,
në mur shoh vrimat e breshërisë së egër;
mbi barin e gjelbër ndritin pika vese,
plumbi që ju vrau më djeg në zemër!

Ato plagë na therin e dhembin,
o këshilltarë trima nga Hekali,
veprën tuaj të shenjtë dhe emrin
i ruajmë të pastra si burim mali...

59 VJET

— Veteranit të hidrocentraleve

Ai ngjitet ngadalë te mikrofoni,
i qetë,
i sigurt flet:
59 vjet jetëshkrim drite,
59 vjet.

Djersën e kripur mbi diga fshiu,
buzëqeshjen fisnike
e mbolli mbi bjeshkë,
tuneleve çau përherë i pari
59 vjet.

Flet për liqenin e ri të Fierzës
e zemra i madhohet
si det,
me llamba të bardha i mbushen
59 vjet!

VDEKJA E IDHULLIT

Kazmat tona nguleshin mbi truall,
ku thuhej se prehej dervishi Abaz...
Tyrbja e tij me arkitekturë të huaj
na vështronte me tmerr e maraz.

Atje gjyshi dhe gjyshja dikur
uleshin shpesh me fytyrë të zbehtë,
lotët e hidhur ua mjegullonin sytë
kur shihnin me ankth tyrbën e zezë.

Kazmat tona rrëmuani nëpër baltë,
po nuk hasën në eshtrat e Abazit:
një skelet, një kafkë kali e bardhë,
doli nga fundi i errët i varrit.

Dhe kazmat tona tyrbën e prishën,
pluhuri i saj u shpërnda në erë...
Unë vështroja e gëzuar gjyshen,
që queshte me idhullin e rremë.

1968

17



MIDIS MALESH TË ASHPRA

Midis malesh të ashpra
rritet Fierza me shtat të gurtë,
me sytë copëra dielli...

Midis ujërave të turbullta
Fierza rri zgjuar ditë e natë,
zemrës së atdheut ia shton pulsin!

Mbi brigjet shkëmbore
sondat mbjellin epikën e klasës,
rrënjet e dritës ngulin në tokë...

LULËMOLLA DO TË ÇELË

Godet kazma tokën e ngrirë,
zemra nga gëzimi gufon
mbi shkurret, në tokën rrëpirë
tarraca si vetull ngjason.

Fidane kumbullash, mollësh,
do të mbijnë mbi tokën e re,
i bukur do të rritet ky bllok,
se djersa u derdh rrëke.

Fluturat e borës shtohen,
po kazma godet më thellë;
mbi bimët e egra që shkulen
lulemolla rozë do të çelë...

D J A L I

Doçkat pérherë i tund
dhe qan me zë kumbues,
se ka mami e babi punë
aq i bën këtij vogëlushi.

Në shtëpizën tonë të re
buron dritë, dritë, dritë;
ky që me nina-nana fle
do bëhet burrë një ditë.

I vockël sot e i çuditshëm
nesër me gjoks do të çajë mal,
në një kantier të madh, të ndritshëm,
do të ndërtojë hidrocentral...

KY VIT I RI

Ky Vit i Ri s'është si të tjerë,
më afër komunizmit do ta hedhim hapin,
më shumë grurë fushat do të kenë,
furrnaltat më shumë metal do të japin.

S'është si të tjerë ky VIT I RI,
epoka e lirisë në sy më sheh sot;
mbi fletën e bardhë e menduar rri:
Çfarë s'të kam dhënë, o e dashur tokë?

E di që të kam dhënë fare pak,
o koha ime, binjake e komunizmit!...
Për ty djersij e mendoj çdo çast,
ti ma rrit krenarinë dhe gjëzimin.

V E T E R A N Ě T

Në fjalët e veteranëve
gjelbëron heroizmi,
si lule e kuqe çel liria.

Në sytë e veteranëve
ndez fishekzjarrët gëzimi,
bardhësinë marrin pëllumbat.

Në duart e veteranëve
prekim revolucionin,
ndiejmë ngrohtësinë e stafetës...

FLOKËT MË NGATËRROHEN ME HALA PISHE

Sa magjepsës është ky kënd i brishtë,
ku zilka tufash tringëlljnë që larg;
dëbora në majë zbardhon si grigjë,
në liqen të Ponarëve pisha kokën lan.

Të duket sikur rrëshqet paprerë
mbi krahët e bardhë, të lagët të reve,
dhe era tingujt e gjelbër i merr,
si melodi i nis poshtë xhadeve...

Këtu plot ngazëllim sot u mbusha,
plot motive të freskëta si burime;
më gurgullojnë në shpirt dhjetëra gurra,
flokët më ngatërrohen me gjethe pishe.

PËR JU, NËNA

Vargje të thjeshta
si fjalët tuaja.

Vargje të blerta
si dashuria juaj.

Vargje të dhembshura
si vështrimet tuaja.

Vargje të ngrohta
si dora juaj.

Vargje madhështore
si vetë ju!...

B R E G D E T

Deti kraharorin e fryn,
si vargmale dallgët ngrihen lart;
Ademi mbi to shndrit si yll,
ngjan Frani si flamur në katart.

E duam këtë det ujëkaltër,
që në shekuj e lakmuani armiqtë;
edhe gjakun tonë do të japim,
në prekshin nga ky ujë një pikë!

NËNA SHQIPËRI

Me zemër fisnike
përcolle ndër beteja
bijtë dhe bijat e njoma.

Me fytyrë dielli
vështron krenarë
në kohëra!

ËSHTË GJITHÇKA

Është gjithçka krenare në monumentet e të rënëve:
heroizmi i gjallë i mbjellë në kohëra.

Është gjithçka solide në hekurudhën e rinisë:
duarshtrengimi i fuqishëm i brezave.

Është gjithçka pranverë tek uniforma kaki:
siguria e lirisë sonë me rrënje gjaku.

Është gjithçka e bukur në fjalët e fëmijëve:
poemat e nesërme me mendime të kthjellta.

Është gjithçka kuptimplotë tek Shqipëria e vogël:
zëri i saj mbush kontinentet e vitet.

GËZIM MALËSORI

Sa djersë u bashkua
me lumin e vrullshëm,
zemërak!...
Sytë e përzunë gjumin
dhe duart
s'pushuan asnjë çast.

Tuneli mbaroi,
sytë e ndërtuesve qeshën...
Drini në tunel u përplas
me gjëmim.
Një malësor qeleshen e bardhë
lumit
ia dha si kujtim!

VJELËSJA E QESHUR

Pylli i gështenjave
ka marrë ngjyrën e vjeshtës,
boçja e madhe sa grushti
e hapur
buzëqesh prej degës.

Duart e shkathëta
mes gjetheve fëshfërijnë...
Ja pirgu
dhe zemra e malësores
zmadhohet sa ky pirg!

Nën qerpikët e gjatë
vjetësja e re qesh,
tërë vjeshta
me begatinë e saj
dukët sikur feks...

Makina gjarpëron
rrugëve të atdheut.
Me gështenjat
niset dhe zemra
e vjelëses së qeshur.

VIZATIM NË PRANVERË

Këtu në bjeshkët alpine
pranvera vjen,
dhe flokë bore kristaline
në lule kthenen.

Gurrë e argjendtë shushurin
ëmbël nën mal,
si vals i Shtrausit me violinë,
si vals i bardhë.

Nxitohet qielli i hirtë,
retë i përzë.
Ah, kaltërsinë e qelqtë
zemra s'ma nxë!

Vështroj aq larg e tretem
në hapësirë.
Sa mbushet syri i etur
me tokë të dëlirë!

O BACË BAJRAM

Dëbora pirg,
qielli gri;
shqiponjë malesh
ndër shkrepia rri,
o bacë Bajram.

Kadri Mehmeti
me kobure në brez,
kuletën e rëndë
peshon si mblesë,
o bacë Bajram.

Shpella e bardhë
mes tytash mbeti,
banditëve u prin
Kadri Mehmeti,
o bacë Bajram.

Re dhe u ngrite
madhështor,
kreshtat epike
të rrinë kurorë,
o bacë Bajram!

S O L I D A R E

Dielli nxori kokën këtë mëngjes,
na përshëndeti me ngrrohtësinë e rrezeve;
djersa derdhet çurg në fushat e Myqeqesë
ku breshëri shkatërrroi lule e gjethë.

Bleron e lulëzon prapë kjo tokë,
duart e ashpra lëvizin pareshtur,
fusha e rimbjellur na duket sot
si një nuse e bukur dhe e qeshur.

Ndritin sytë e myzeqarëve të gëzuar,
kur krah për krah me ta punojnë
njerëz të palodhur që i ka bashkuar
dashuria e jote e madhe, revolucion...

GJITHË JETËN

Gjithë jetën me njerëzit,
me përpjekjet, me èndrrat,
me ritmet e kohës sonë,
me krijimet dhe këngët.

Gjithë jetën me rrugët,
me krismat, shqetësimet,
me metalet dhe grunjërat,
me idetë e Partisë sime!

H E R O I N A

Kokë e thinjur,
zemër e bardhë,
sy të thelluar,
brazda në ballë.

Armiku i egër
një ditë dhjetori,
ta vrau vajzën,
vajzën ta mori.

Sytë s'i përlote
atë ditë të ftohtë;
armën rrëmbeve,
rende si shqotë.

Dhe u rreshtove
me partizanë,
vrave fashistë,
vrave tradhtarë...

Re në një grykë
me gaz në zemër,
sot madhështore
ke emër tjetër!

INTRODUCERE

Qëdo e bëjë mend që këtia do të bëjë
një libri i ri i këtij vëllai, që
dëshironi që këtia përdorimë sot, këtë
njëq i bëj mënyrë et nuk më

poftësuar qëndroj si përfundim
një libri i ri i këtij vëllai
dëshironi që këtia përdorimë sot, këtë
njëq i bëj mënyrë et nuk më

poftësuar qëndroj si përfundim
një libri i ri i këtij vëllai
dëshironi që këtia përdorimë sot, këtë
njëq i bëj mënyrë et nuk më

MBRËMJE DIMRI

Ndizet drita në mbrëmjen e qetë,
ato hyjnë si agimi i një dite;
nga flokët shkundin borën e lehtë
dhe ulen te tryeza prej pishe.

Zëra të çiltër, fëmijërorë,
bulojnë e hapen mbi ditar,
cicërojnë e sillen nëpër dhomë
si zogj të bardhë, të bardhë....

Sytë e mësueseve të fshatit
mbushen me hapësira pranvere,
jashtë era troket te xhami,
thur dimri rapsodi të re.

V I E T N A M

Ky emër në zemër të viteve
kish hyrë si një plagë,
ky emër këtë ditë prilli
çeli si zambak i madh.

Qielli blu solli që larg
cicërima e thirrje gjëzimi,
zërin e çiltër ne ngremë lart:
nga gjaku blerojnë liria dhe prilli!

30 prill 1974

PAS DY VJETËSH

Shpërndarë në çdo kënd të Atdheut
një qëllim na bashkon në jetë,
si lumenjtë që zbresin nga malet
e derdhen natyrshëm në det...

Zërat e çiltër e të burrëruar
këtë mbrëmje duken më të afërt,
janë shokët e mi ballëmenduar,
që flasin për vise të largët.

Për uzinën e naftës Spiroja tregon,
Vera ngre probleme të rinisë,
me pasion unë flas për malësorë,
ndërsa nata e korrikut bie si tis.

Diana, Çapajevi, Leta, Besimi
thonë edhe ata diçka të mirë,
ndër sy na lulëzojnë këto vite
mbushur me jetën e re të lirë!

«M A L I»

Ata zgurdulluan sytë dhe heshtën,
përballë tyre qëndroje lapidar;
durimi u sos, vrasësit u ngërdheshën,
po s't'u drodh shikimi krenar...

Me dorën e enjtur nga zinxhirët
tregove diellin në horizont,
në sy të feksi agimi i lirë,
zëri yt burrëror kumboi fort.

Gjaku i kuq të rroddhi valë-valë,
tek bije, u shndërrrove në flamur;
buzëqeshja jote mbi atdhe u përhap,
gjoksi yt i shpuar u kthyen në bust.

*) Mali ishte pseudonimi i Manush Alimanit

PËRCJELLJE

Pas pak do të ikësh larg,
erë e dimrit fort fërshëllen,
Vajti ora.... Gati gjithçka,
çantën e gjeologut ti mbërthen.

Dalim së bashku te stacioni,
unë s'përlotem si sentimentale,
po të përcjell mes shiut e borës
se rruga jonë është e madhe.

Mbi lartësitë e këtyre maleve
fytyra jote e qeshur më del,
ti me duart plot minerale
plot ngazëllim më përshtendet.

Qëndroj në trotuarin e lagur,
ti i heshtur nga xhami vështron:
— Mirupafshim përsëri, e dashur,
ndarje të tilla koha na kërkon!...

NJERËZIT E UGAREVE

Drurëve mugullojnë sythat,
toka lëshon avull paprerë;
plugjet e mëdha çajnë plisat,
bujqit nxitojnë për të mbjellë.

Brazdat e qëndisin fushën,
agronomi nëpër ngastra rend;
epike bêteja për bukën,
për bukën e prodhuar në vend!

Shtohet një kapitull i ri
në poëmën epike shqiptare,
për ata që djersë, dashuri
u japin çdo ditë ugareve.

«SHTËPI E BARDHË»

Shtëpi e Bardhë, —
mjegull gri
mbi tyta pushkësh.

Shtëpi e Bardhë —
buzëqeshje e ngrirë
mbi fytyra të vdekurish.

Shtëpia e Bardhë —
me njolla gjaku
dyshemesh, muresh.

Shtëpi e Bardhë —
t'u ndërroftë emri
në «Shtëpia e zezë»!

E NGROHTE

Mibi Alpe bie muzgu i kaltër,
vogëlushi ecën midis nesh,
si në mbrëmjen e njohjes së parë
na rreh zemra dhe buza na qesh.

Fjalë të pathëna flasin sytë,
fjalë të ngrohta plot drithërim;
mbi asfaltin e ngjer me dritë
vogëlushi ynë hidhet me gëzim.

Ndiejmë se diçka e re, e madhe,
me tokën e me kohën na bashkon:
krahëhapur si pëllumb i bardhë
vogëlushi me dashuri na përqafon...

MEDITIM

Vjeshta flokëshpleksur vrapon
nëpër livadhe dhe drurë,
era e nëntorit
fërshëllen grykave,
pyllin e kuqëremtë po shkund...

Vështroj e menduar pyllin
me gjethe të grisura, të lagura,
më ngjan
si ditar partizan
plot ngjarje ditësh të përflakura!

Stina e blerimeve të mëdha
nisë
te kjo vjeshtë e tretë,
nëpër dritaret partizane
fletët e heroizmit
shpalosen të kuqe përjetë.

NË STACIONIN E FIERZËS

Po të pres, i dashur...

Autobusi i linjës së Fierzës
edhe këtë herë pa ty kaloi.

Ndoshta në thellësi të tunelit
këto çaste saldon çentinat e metalta
nën vështrimet e ashpra të shkëmbit.

Ndoshta këtë çast
mua më buzëqesh nga larg,
me buzëqeshjen tënde që më fal gjithçka të
bukur.

Kaloi autobusi tjetër...

Dëbora që zbriti nga malet si grigjë
i mbushi rrugët me bardhësinë e saj.

Fluturzat e kristalta të borës

mbi flokët e lagur më ulen butë-butë
si prekja e dashur e gishtave të tu...

I dashur, ende po të pres!

PASQYRA E LËNDËS

- Krijimi	3
- Për Diellin tonë PPSH	4
- Vajza e dritës	5
- Në stan	7
- Mëngjes	8
- Fushë e artë	9
- Maj	10
- Pleqve të Kruijës	11
- Kohë tjeter	12
- Bashkudhëtarë	13
- Një tufë lule	14
- Si burim mali...	15
- 59 vjet	16
- Vdekja e idhullit	17
- Midis malesh të ashpra	18
- Lulemolla do të çelë	19
- Djali	20
- Ky Vit i Ri	21
- Veteranët	22
- Flokët më ngatërrohen me hala pishe	23
- Për ju, nëna	24
- Bregdet	25
- Nëna Shqipëri	26
- Është gjithçka	27

— Gëzim malësori	28
— Vjelësja e qeshur	29
— Vizatim në pranverë	31
— O bacë Bajram	32
— Solidare	34
— Gjithë jetën	35
— Heroina	36
— Mbrëmje dimri	38
— Vietnam	39
— Pas dy vjetësh	40
— Mali	41
— Përcjellje	42
— Njerëzit e ugareve	43
— «Shtëpi e bardhë»	44
— E ngrohtë	45
— Meditim	46
— Në stacionin e Fierzës	47

Tirazhi 1000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtyshkronja e Re
Tiranë, 1979